



EmpowerMed

Incentiva për pajisje të reja, investimet BRE dhe EE

Paketë pune 2 – Materiale trajnimi
Versioni final, prill 2020



“



Paketa e punës: WP2 – Forcimi i kapaciteteve në zbatimin e masave praktike
Drejtues i paketës së punës: SOGESCA
Partneri përgjegjës: SOGESCA
Produkti 2.2: Materiale trajnimi

Autor: Silvia Franceschi

Versioni: Final

Data: Prill 2020

Shënim i rëndësishëm: Riprodhimi i pjesshëm ose i plotë i përmbajtjes lejohet me autorizimin nga autorët dhe me citimin e burimit.



Ky projekt financohet nga Programi i Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 të Bashkimit Evropian, kontrata Nr. 847052. Autorët janë përgjegjës të vetëm për përmbajtjen e këtij dokumenti. Nuk reflekton domosdoshmërisht mendimin e BE. As EASME dhe as Komisioni Evropian janë përgjegjës për informacionin e përdorur në të.

TABLA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	4
1 Veprime Evropiane	5
1.1 Rregulla që pajisjet shtëpiake të jenë më shumë të qëndrueshme	5
1.2 Rregulloret e reja që përcaktojnë kërkesat për eko-modelim	6
1.3 Etiketat e energjisë.....	6
2 Veprime në zonat e projektit	8
2.1 Itali	8
2.2 Spanja.....	12
2.3 Franca.....	13
2.4 Kroacia.....	14
2.5 Shqipëria.....	15
2.6 Sllovenia	16
3 Fizibiliteti dhe investimet për BER dhe EE	17
4 Investimet BER dhe EE në zonat e projektit	18
4.1 Itali	18
4.2 Spanja.....	19
4.3 Franca.....	20
4.4 Kroacia.....	21
4.5 Shqipëria.....	22
4.6 Sllovenia	23
5 Shtojca	26
Shtojca 1 - Tabela e incentivave	27
Shtojca 2 - Tabelë energjie	29



HYRJE

Në raportin vijues përshkruhen të gjitha llojet e stimujve kombëtar dhe evropian që adresohen për nevojat e konsumatorëve.

1 Veprime Evropiane

1.1 Rregulla që pajisjet shtëpiake të jenë më shumë të qendrueshme

Vlerësohet se rreth gjysma e emetimeve të gazrave serë nga një pajisje shtëpiake janë për shkak të procesit të saj të prodhimit, dhe gjysma e mbetur nga përdorimi i saj në ciklin jetësor. Në përpjekje të vazhdueshme për të zvogëluar gjurmët e karbonit në Evropë dhe për t'i bërë faturat e energjisë më të ulta për konsumatorët evropianë, BE ka vendosur rregullore dhe direktiva, veçanërisht për etiketimin e energjisë dhe eko-modelimin për produktet.

Komisioni është duke përmirësuar eko-modelimin e produkteve, duke kontribuar kështu në zbatimin e parimit të parë të efikasitetit energjetik të prioritetit të Bashkimit të Energjisë së BE-së. Për herë të parë masat përfshijnë kërkesa për riparueshmërinë dhe riciklueshmërinë, duke kontribuar në objektivat e ekonomisë qarkulluese, duke përmirësuar jetëgjatësinë, mirëmbajtjen, ripërdorimin, azhurnimin, riciklueshmërinë dhe trajtimin e mbetjeve të pajisjeve.

Komisioni vlerëson se këto masa, së bashku me etiketat e energjisë të miratuara në 11 mars, do të japin 167 TVo (TWh) të kursimit të energjisë përfundimtare në vit deri në vitin 2030, uljen e mbi 46 milion ton ekuivalentin e CO₂ dhe kursimin për familjet evropiane prej 150 Euro në vit. Këto kursime vijnë mbi ato të arritura nga kërkesat ekzistuese të eko-modelimit dhe etiketës së energjisë, të cilat do të sjellin një kursim vjetor të energjisë rreth 150 Mtoe (milion ton ekuivalent naftë) deri në vitin 2020. Për konsumatorët, kjo do të thotë një kursim mesatar 285 € në vit në faturat e energjisë në shtëpitë e tyre.



1.2 Rregulloret e reja që përcaktojnë kërkesat për eko-modelim

Më 1 tetor 2019, Komisioni Evropian miratoi masa të reja eko-modelimi për produktet, të cilat përcaktojnë efikasitetin e energjisë dhe kërkesat e tjera për grupet e mëposhtme të produkteve: frigoriferë; lavatriçe; pjatolarëse; ekranet elektronike (përfshirë televizorët); burime drite dhe ingranazhe kontrolli të veçantë; furnizime me energji të jashtme; motorrë elektrikë; frigoriferë me një funksion të shitjes direkte (p.sh. frigoriferë në supermarkete, makina shitëse për pije të ftohta); transformatorët e energjisë; dhe pajisjet e saldimit.

Legjislacioni i BE-së për eko-modelim është një mjet efektiv për të përmirësuar performancën mjedisore të produkteve, duke vendosur standarde minimale të detyrueshme për efikasitetin e tyre energjetik. Kjo eliminon produktet me më pak performancë nga tregu, duke kontribuar ndjeshëm në objektivin e BE-së për efikasitetin e energjisë.

10 rregulloret janë:

- 1) Eko-modelim për frigoriferët e shtëpisë - C(2019) 2120
- 2) Eko-modelim për burimet e dritës - C(2019) 2121
- 3) Eko-modelim për ekranet elektronike - C(2019) 2122
- 4) Eko-modelim për pjatolarëset - C(2019) 2123
- 5) Eko-modelim për makinat larëse dhe tharëse të rrobave - C(2019) 2124
- 6) Eko-modelim për motorrët - C(2019) 2125
- 7) Eko-modelim për pajisjet jashtme të energjisë- C(2019) 2126
- 8) Eko-modelim për frigoriferët shitës të jashtëm - C(2019) 2127
- 9) Eko-modelim për transformatorët e energjisë - C(2019) 5380
- 10) Eko-modelim për pajisjen e saldimit - C(2019) 6843

1.3 Etiketat e energjisë

Etiketat e energjisë së BE-së ofrojnë një tregues të qartë dhe të thjeshtë të efikasitetit energjetik të produkteve në pikën e blerjes. Kjo e bën më të lehtë për konsumatorët të bëjnë zgjedhje më të sakta kur blejnë pajisje dhe të kursejnë para në faturat e energjisë së shtëpisë, duke ulur emetimet e gazeve në të gjithë BE-në.

Koncepti ka qenë një nxitës kryesor për të ndihmuar konsumatorët të zgjedhin produkte që janë më efikase në energji. Në të njëjtën kohë, ajo gjithashtu inkurajon prodhuesit drejt inovacionit duke përdorur teknologji më efikase të energjisë.

Komisioni miratoi në 11 Mars 2019 një format përfundimtar dhe identitetin vizual të etiketave të reja për grupet e mëposhtme të produkteve:

- 1) frigoriferët, përfshirë frigoriferët për ruajtjen e verës
- 2) lavastoviljet
- 3) makinat larëse dhe tharëse të rrobave
- 4) ekranet elektronike përfshirë televizorët
- 5) llambat
- 6) pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkt



Etiketat u riklasifikuan dhe shkalla e energjisë u zhvendos nga A në G, e cila është më e thjeshtë dhe më e kuptueshme nga konsumatorët.

Këto etiketa të reja do të jenë të dukshme për konsumatorët evropianë në dyqane dhe on-line që nga 1 Mars 2021.

2 Veprime në zonat e projektit

2.1 Itali

Në Itali, veprimet për blerjen e pajisjeve të reja mund të përmbliidhen nga tabela e mëposhtme, sipas tre llojeve të ndërhyrjeve.


Kursimi i energjisë	Rimobilimi	Mobilimi
	<i>Rinovimi i ndërtesave, pajisjeve shtëpiake). Zbritja e 50% të shpenzimeve të bëra për rinovimin e ndërtesave dhe për blerjen e mobiljeve dhe pajisjeve të mëdha.</i>	
<i>Rikualifikimi i energjisë të ndërtesave (Ecobonus) Zbritja e taksave nga 50% - 65% për disa ndërhyrje të rihvillimit të energjisë në njësitë individuale të pasurive të patundshme dhe në pjesët e zakonshme të ndërtesave.</i>		

Më shumë lehtësi mund të gjendet në faqen e internetit Agjencia e të Ardhurave Italiane, e cila është një agjenci që zbaton kodin financiar të Italisë dhe mbledh taksat dhe të ardhurat.

Portale online

Për informacion më të plotë, konsumatori mund të hyjë në portalin në internet të Agjencisë së të Ardhurave, ku mund të gjejë të gjitha informacionet tatimore që lidhen me mjediset e shtëpisë në linkun si më poshtë:

<https://www.agenziaentrate.gov.it/portale/ëeb/guest/aree-tematiche/casa/agevolazioni>



Bonus i pajisjes - Ligji Nr. 160/2019 - neni. 1, paragrafi 175

● Çfarë është

Është një zbritje e taksës mbi të ardhurat personale për blerjen e mobiljeve dhe pajisjeve të mëdha të një klase jo më të ulët se A + (A ose më e lartë për furrat dhe lavatriçet larëse dhe tharëse), me qëllim që të sigurojë një aset që i nënshtrohet rinovimit. Zbritja duhet të llogaritet në një shumë maksimale prej 10,000 Euro, përfshirë çdo kosto transporti dhe montimi.

● Kujt i intereson

Ata që blejnë mobilje dhe pajisje të reja dhe kanë kryer rinovime në ndërtesë, mund të përfitojnë nga zbritja.

● Përparësitë që ka

Pavarësisht nga shuma e shpenzimeve të bëra për punimet e rinovimit, është e mundur të përfitohet nga një zbritje prej 50% e llogaritur në një shumë maksimale prej 10,000 Euro, duke iu referuar, në total, shpenzimeve të bëra për blerjen e mobiljeve dhe pajisjeve të mëdha, për njësi të vetme e pasurive të patundshme, përfshirë apartamentet, ose pjesën e përbashkët të ndërtesës që rinovohet.

Ndërhyrjet në ndërtimin, të domosdoshme për zbritjen janë:

- mirëmbajtje, restaurim dhe rehabilitim, rinovim i ndërtesave në apartamente individuale;
- rindërtimi ose restaurimi i një ndërtese të dëmtuar nga ngjarje fatkeqësie, nëse është deklaruar gjendje e jashtëzakonshme;
- restaurimi, rehabilitimi dhe rinovimi i ndërtesave, në lidhje me ndërtesat e tëra, të bëra nga ndërmarrjet e ndërtimit ose rinovimet e pasurive të paluajtshme dhe nga ndërtimi i kooperativave që shesin ose caktojnë pronën brenda 18 muajve nga përfundimi i punimeve;
- mirëmbajtje e zakonshme, mirëmbajtje e jashtëzakonshme, restaurim dhe rehabilitim, rinovim në pjesët e zakonshme të ndërtesave të banimit.

Zbritja është për shkak të blerjes së:

- mobiljeve të reja: shtretër, dollap, rafte librash, tavolina, karrige, tavolina në shtrat, divan, kolltuqe, dërrasat anësore, dyshekët, pajisjet e ndriçimit. Blerja e dyerve, material për dyshemetë (për shembull, parket), perde dhe pajisje të tjera arreduese janë të përjashtuara.
- pajisjeve të reja: klasa e energjisë jo më e ulët se A + (A ose më e lartë për furrat dhe tharësit) siç tregohet në etiketën e energjisë. Sidoqoftë, blerja është lehtësuar për pajisje pa etiketë, me kusht që detyrimi ende nuk është përcaktuar për ta. Pajisjet e mëdha shtëpiake përfshijnë, për shembull: frigoriferë, makina larëse dhe tharëse, pjatararëse, pajisje gatimi, soba elektrike, furra me mikrovalë, pjata elektrike të nxehta, ngrohje elektrike, radiatorë elektrikë, tifoze elektrike, pajisje për ajër të kondensuar.

Ecobonus

● Çfarë është

Tatimpaguesit që kryejnë ndërhyrje që rrisin nivelin e efikasitetit të energjisë së ndërtesave ekzistuese mund të zbresin një pjesë të shpenzimeve të bëra për punën nga tatimi mbi të ardhurat personale (Irpef, në shqip TAP) ose nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave (Ires). Në veçanti, mbajtësit e të ardhurave të biznesit mund të përfitojnë nga zbritja vetëm duke iu referuar ndërtesave të përdorura gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

● Kujt i intereson

Objekti ka për qëllim të gjithë tatimpaguesit, rezidentët dhe jorezidentët, të cilët zotërojnë pronën që i nënshtrohet ndërhyrjes. Përveç pronarëve, ndër të tjera, pronarët e një të drejte reale mbi pronën, godinat (për ndërhyrje në pjesët e përbashkët të godinës), qiramarrësit dhe huamarrësit mund të përfitojnë nga objekti. Përveç kësaj, zbritja mund të përfitohet nga anëtarët e familjes që bashkëjetojnë me pronarin ose mbajtësin e pasurisë që i nënshtrohet ndërhyrjes (bashkëshorti, anëtar i bashkimit civil, të afërmit brenda shkallës së tretë dhe të ngjashme brenda shkallës së dytë) dhe nga bashkëjetuesi më i madh.

● Cilat janë avantazhet

Shuma që do të zbritet nga taksat mund të ndryshojë nga 50% në 85% të shpenzimeve bazuar në karakteristikat e ndërhyrjes. Shpenzimet e pranueshme në zbritje përfshijnë si kostot për punën në lidhje me ndërhyrjen e kursimit të energjisë, ashtu edhe ato për shërbimet profesionale të nevojshme për të kryer vetë ndërhyrjen dhe për të marrë certifikimin e kërkuar të energjisë.

Në përgjithësi zbritjet njihen për:

- ulja e nevojave për energji për ngrohje,
- përmirësim termik të ndërtesës (izolimi - dyshemetë - dritaret, përfshirë instalimet),
- instalimin e paneleve diellore,
- zëvendësimin e sistemeve të ajrit të kondicionuar.

Zbritja është gjithashtu për shkak të:

- blerjes dhe instalimit të paneleve të diellit,
- blerjes dhe instalimit të sistemeve të ajrit të kondicionuar të dimrit të pajisur me gjeneratorë të nxehtësisë të mundësuar nga karburantet e biomasës,
- blerjes, instalimit dhe zbatimit të pajisjeve multimedia për kontrollin në distancë të sistemeve të ngrohjes, prodhimin e ujit të nxehtë ose kondicionimin e njësive të banimit.
- blerjes dhe instalimit të mikro-kogjeneratorëve për të zëvendësuar impiantet ekzistuese,
- blerjes së gjeneratorëve të ajrit të nxehtë kondensues; zëvendësimi i sistemeve të ajrit të kondicionuar të dimrit me pajisje hibride të përbërë nga një pompë nxehtësie e integruar me kazan kondensimi.

2.2 Spanja

Në Spanjë, çdo rajon organizon sipas mënyrës disa veprime/incentiva për klientët. Në Katalunja, rajon autonom ku është pozicionuar edhe Barcelona janë:

- **Plani Rinovimit për pajisjet elektroshtëpiake:** veprimet/incentivat për pajisjet elektroshtëpiake në varësi të pajisjes duke filluar nga etiketa A++ ose A+++.

2.3 Franca

Në Francë nuk ka incentiva në nivel kombëtar ose rajonal për të blerë ndonjë pajisje me energji të efektshme. Disa autoritete lokale mund të mbështesin familjet e cënueshme përmes veprimeve shoqërore në rast të këtij lloj blerjeje.

Në Francë ekziston një mbështetje kombëtare për familjet më të ardhura të ulëta, **MaPrimeRenov**, për pajisjet për kursimin e energjisë si:

- deri në 1,200 Euro për zëvendësimin e bojlerit.
- deri në 4,000 Euro për systemin e ngrohjes (sistem ajri-uji) dhe 10,000 Euro për sistemin ngrohës gjeotermal.

Për më shumë informacion:

<https://www.cohesion-territoires.gouv.fr/sites/default/files/2019-12/MaPrimeRenov-Pr%C3%A9sentationdetailed.pdf>

2.4 Kroacia

Në Kroaci kanë qenë disa veprime/incentiva në të kaluarën: Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Efiçencën e Energjisë menaxhoi subvencione për qytetarët të cilët blenë pajisje shtëpiake me efiçencë energjie. Në 2015 u hap një thirrje, bazuar në principin “cili vjen më parë, i shërbehet të parit” dhe subvencionet u morën nga qytetarët që kishin aplikuar të parët. Ministria dhe Fondi shpërndan 16 milion kuna (rreth 2.1 milion Euro) përgjatë këtij programi. Qytetarët përfituan nga 800 kuna (afërsisht 105 Euro) për pajisjet e kategorisë A+++ . Pasi fondet u shpërndanë, programi nuk mori më fonde të mëtejshme dhe tashmë ai është mbyllur.

2.5 Shqipëria

Në Shqipëri nuk ka ende ndonjë përfitim apo veprim/incentivë për klientët.

Ka vetëm kredi të buta të dhëna nga bankat për pajisjet me Eficencë Energjie, bojler dhe kaldajat e ngrohjes.

Ministria e Infrastrukturës dhe energjisë më asistencën e EBRD janë duke rishikuar ligjin ekzistues Nr. 124/2015, i datës 12.11.2015 “Për eficientë e energjisë” duke synuar përafrimin e plotë të tij me dispozitat e Direktivës 2012/27/EU për eficientë e energjisë, ndryshimi i Direktivave 2004/8/EC dhe 2006/32/EC.

2.6 Sllovenia

Në tabelën vijuese janë paraqitur incentivat për pajisjet shtëpiake dhe pajisjet sipas normativës sllovene.

Pajisjet	Veprimet/incentivat
Soba	Kredi e favorshme për pajisjet shtëpiake të klasës A + ose më të lartë: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/gospodinjski-aparati-a-ali-visjega-razreda
Makina larëse	Kredi e favorshme për pajisjet shtëpiake të klasës A + ose më të lartë: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/gospodinjski-aparati-a-ali-visjega-razreda
Lavastovilje	Kredi e favorshme për pajisjet shtëpiake të klasës A + ose më të lartë: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/gospodinjski-aparati-a-ali-visjega-razreda
Bojler	Kaldaja e kondensimit - investime individuale: deri në 50% ose 2000 Euro, investime në ndërtesa shumëkatëshe: 25% e investimeve; gjithashtu janë në dispozicion kredi të favorshme; më shumë informacion gjeni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/kondenzacijski-kotli ; bojler me përdorim të biomasës – investime individuale: nga 20-60% ose 2,000-5,000 EURO, investime në ndërtesat shumëkatëshe: 25%, shtëpitë më varfëri energjitike: 100%; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion. Për më shumë info në: <a ;"="" href="https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/kuriline-naprave-na-lesno-biomaso-optimisation-of-heating-system-in-multi-flat-buildings-up-to-20%">https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/kuriline-naprave-na-lesno-biomaso-optimisation of heating system in multi-flat buildings: up to 20%; more info at: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/optimizacija-sistema-ogrevanja-v-vecstanovanjski-stavbi
Sistemi i ngrohjes	Investime individuale: nga 20-60% ose 2,000-5,000 Euro, ndërtesat shumëkatëshe: 25%; kredi të favorshme janë në dispozicion: për më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/toplotne-crpalke

3 Fizibiliteti dhe investimet për BER dhe EE

Tranzicioni i energjisë së rinovueshme do të sjellë shumë ndryshime në aspekte të ndryshme të sektorit të energjisë. Nëse nuk miratohen masat e duhura, ndryshimet në sektorin e energjisë mund të rrisin numrin e familjeve të rrezikuara nga energjia, ose të varfëria nga energjia. Rritja e tarifave për shkak të skemave të mbështetjes së Burimeve të Energjisë së Rinovueshme (BER) mund të bëhet një barrë shtesë për popullatën e ndjeshme ndaj energjisë. Mbyllja e hendekut financiar ose pagesa e faturave të rritura të energjisë mund të jetë e përealizueshme për familjet në nevojë. Në fakt, individët me të ardhura të ulëta shpesh qëndrojnë jashtë fushës së masave të efikasitetit të energjisë. Aty ku ka shumë familje të rrezikuara nga energjia, zgjidhjet e efikasitetit të energjisë duhet të synojnë specifikisht edhe klientët e prekshëm. Ndryshimi i shpejtë në sistemin e energjisë kërkon një mënyrë të re për të kuptuar politikat e energjisë së rinovueshme. Për këtë arsye, politikat për të mbështetur tranzicionin duhet të miratojnë një qasje holistike që llogarit këto elemente.

Politikat që nxisin tranzicionin duhet të mbulojnë jo vetëm vendosjen e burimeve të rinovueshme, por edhe integrimin e tyre në sistemin më të gjerë të energjisë dhe politikat e ekonomisë, të cilat ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe ritmin e tranzicionit (IRENA / IEA / REN21, 2018). Si pasojë, hartimi i politikave mbështetëse për vendosjen e energjisë së rinovueshme në një situatë të cenueshmërisë difuze të energjisë ose varfërisë duhet të adresojë përballueshmërinë e energjisë, e cila nga ana e saj varet nga modelet e konsumit dhe çmimi i energjisë, dhe duhet të jenë zgjidhje afatgjata për çështjet e varfërisë së energjisë dhe masat e efikasitetit të energjisë.

Masat e efikasitetit të energjisë janë të nevojshme në shumicën e familjeve të varfëra nga energjia dhe të rrezikuara nga ajo. Efikasiteti i energjisë zvogëlon konsumin e energjisë dhe përmirëson cilësinë e jetës në banesa (zvogëlimi i lagështisë dhe ndotjes së brendshme të ajrit). Zgjidhjet e efikasitetit të energjisë nuk u referohen vetëm banesave, por edhe pajisjeve energjetike. Masat e efikasitetit të energjisë zvogëlojnë gjithashtu nevojën për subvencione tarifore, duke hapur hapësirën fiskale për investime më të mëdha në energji të rinovueshme dhe teknologji të tjera të pastra. Teknologjitë moderne të biomasës mund të ndihmojnë në zvogëlimin e ekspozimit ndaj energjisë dhe ndryshueshmërisë së çmimit të karburantit, ndërsa përmirësojnë cilësinë e ajrit të brendshëm dhe zvogëlojnë sasinë e biomasës së nevojshme për të ngrohur një banesë. Në mënyrë të ngjashme, ngrohësit diellorë të ujit ulin ekspozimin ndaj çmimeve të karburantit për prodhimin e ujit të nxehtë, duke përmirësuar jetesën e familjeve.

Subvencionet financiare mund të jenë të nevojshme për t'i bërë teknologjitë moderne të ngrohjes së rinovueshme të përballueshme. Identifikimi i pikave të nxehta të varfërisë dhe vulnerabilitetit të energjisë lejon përpjekje që mund të rezultojnë në politika më efektive, të përshtatura, të përqendruara në çështjet më të rëndësishme, të cilat mund të ndryshojnë nga rajoni në rajon.

(Burimi: IRENA Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme, "Analiza të tregut të energjisë së rinovueshme – Evropa Juglindore", 2019)

4 Investimet BER dhe EE në zonat e projektit

4.1 Itali

Lehtësimet mund të gjenden në faqen e internetit të GSE, kompania e sektorit të shërbimeve të energjisë, e kontrolluar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila ka për detyrë të ndjekë dhe të arrijë objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore në dy shtyllat e burimeve të rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë.

Portali online - GSE

Për informacion të qartë, konsumatori mund të hyjë në portalin GSE online, ku mund të gjejë të gjithë informacionin në lidhje me koncesionet e efikasitetit të energjisë, në lidhjen e mëposhtme: <https://www.gse.it/>

Sektori GSE i shërbimeve të energjisë, është një kompani e kontrolluar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Detyra e tij është të ndjekë dhe të arrijë objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore në dy shtyllat e burimeve të rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë, duke ndihmuar në formimin e një të ardhme më të qëndrueshme për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Energjitë e rinovueshme - BER

Me VKM. 04/07/2019, përmes mbështetjes ekonomike, promovohet përhapja e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike të vogël, të mesme dhe të madhe nga burimet e rinovueshme.

Impjantet që mund të përfitojnë nga stimujt e parashikuar nga Dekreti janë:

- sisteme fotovoltaike të sapondërtuara
- fermat në breg,
- hidroelektrik,
- gas pastrimi.

Efikasiteti i energjisë - Ilogaria termike

Ilogaria Termike nxit ndërhyrjet për të rritur efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e energjisë termike nga burimet e rinovueshme për impiantet e vogla. Përfituesit janë administrata publike, biznese dhe individë.

Falë Ilogarisë Termike është e mundur të rihvillonin ndërtesat tuaja për të përmirësuar performancën e tyre të energjisë, duke ulur kështu kostot e konsumit dhe duke rikuperuar shpejt një pjesë të kostove të bëra.

Përveç një zgjerimi të metodave të hyrjes dhe të subjekteve të pranuar, janë planifikuar masa të reja të efikasitetit të energjisë. Madhësia e impianteve të pranueshme u rishikua si dhe procedura e hyrjes së drejtpërdrejtë për pajisjet me karakteristika tashmë të aprovuara dhe të certifikuar u modernizua. Pajisjet në të cilat kanë qasje individët privatë janë: Pompat e nxehtësisë, kaldaja me biomasë, penelet diellore, ngrohje uji PDC, sistemet hibride.

4.2 Spanja

Në Spanjë, secili rajon aktivizon vetë disa stimuj financiarë për konsumatorët. Në Katalunja, rajoni autonom në të cilin është vendosur Barcelona ka:

- **Incentivat nga IDEA (Agjencia Energjisë së Barcelonës):** programe të ndihmës publike për të promovuar efijencën e energjisë dhe projekte të energjisë së rinovueshme. Ata janë me moton: të parit i shërbehet (jo social). Për më tepër, për periudhën 2014-2020, IDAE zhvillon punën si ndërmjetësues i Agjencisë për Menaxhimin e Fondeve ERDF kushtuar ekonomisë së karbonit të ulët, brenda Programit Operacional Shumërajonal të Spanjës. Për më shumë informacion: <https://www.idae.es/ayudas-y-financiacion>
- **Incentivat nga ICAEN Instituto Catalán de Energía (Instituti Katalan për Energjinë):** Qeveria Katalanase dhe Konsorciumi Metropolitan i Shtëpisë (Agència de l'Habitatge) ofron programe për rinovim të ndërtesës. Për më shumë info: <https://www.cmh.cat/home>

Edificios

- Agència de l'Habitatge de Catalunya: rehabilitación de edificios de tipología residencial
- Consorci Metropolità de l'Habitatge: ayudas a la rehabilitación de edificios de tipología residencial colectiva y viviendas
- Consorci de l'Habitatge de Barcelona: ayudas a la rehabilitación de elementos comunes
- Consorci de l'Habitatge de Barcelona: Rehabilitación de edificios de personas en situación de vulnerabilidad
- Consorci de l'Habitatge de Barcelona: ayudas a la rehabilitación de viviendas para incorporar a la bolsa de viviendas de alquiler de Barcelona y para el arreglo de viviendas de personas en situación de vulnerabilidad
- [CERRADA] IDAE: Proyectos de rehabilitación energética de los edificios (PAREER II)
- [CERRADA] ICAEN: Sistemas de almacenamiento de energía eléctrica con baterías asociadas a instalaciones fotovoltaicas de autoconsumo 2018
- [CERRADA] ICAEN: Sistemas de almacenamiento de energía eléctrica con baterías asociadas a instalaciones fotovoltaicas de autoconsumo 2017

Figura 1- <http://icaen.gencat.cat/es/energia/ajuts/>

4.3 Franca

Habiter Mieux (Jeto më mirë) është një mekanizëm kombëtar mbështetës për rinovimin rrënjësor, që synon familjet me të ardhura të ulëta. Mbështetja është deri në 70% të shumës totale të masave me një maksimum prej 19,000 €, në varësi të burimeve të ekonomive familjare dhe nga niveli i in/efikasitetit të energjisë së banesës. Kjo është në dispozicion për zotëruesit e pronave, nevojitet një përmirësim prej më shumë se 40% të efikasitetit të energjisë. Pronarët mund të përfitojnë nga mbështetja kombëtare për rikonstrukcionin nëse angazhohen për të nënshkruar një marrëveshje dhe për të aplikuar një qira të ulët.

Një tjetër mbështetje për familjet me të ardhura të vogla është **MaPrimeRenov** për një masë të efikasitetit të energjisë:

- deri në 100 Euro / m² për izolimin e murit,
- deri në 100 Euro / për zëvendësimin e dritareve me një xham të vetëm,
- deri në 4,000 Euro / për ngrohës diellor të ujit,
- deri në 4,000 Euro / për sistemin e ajrimit me rikuperim të nxehtësisë.

Për më shumë informacion:

<https://www.cohesion-territoires.gouv.fr/sites/default/files/2019-12/MaPrimeRenov-Pr%C3%A9sentationdetaillee.pdf>



4.4 Kroacia

Në 2019, **Fondi për Ruajtjen e Mjedisit dhe Efiçencën e Energjisë** hapi një thirrje për qytetarët për grante për instalime të energjisë termale ose për pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes. Kjo thirrje përfshinte instalimin e pompave të ngrohjes, furra pirolotike dhe biomasa dhe panele diellore. Buxheti total ishte 11 mil kuna (afërisht 1.5 mil Euro) dhe qytetarët mund të apliknin për grante me vlerën maksimale, e cila nuk duhet të kalonte 75 mijë kuna (afërisht 10 mijë Euro).

Sipas rinovimit të ndërtesave të banimit dhe shtëpive familjare, Fondi shpalli disa thirrje në periudhën e programit 2014-2020. Qytetarët mund të aplikojnë për thirrje të hapur dhe të marrin një grant për rinovimin e ndërtesës (kostoja që mbulon izolimin, instalimin e dritareve dhe dyerve të reja, çatitë e reja dhe masa të ngjashme me efikasitetin e energjisë). Vlera e subvencioneve shkon nga 29 në 95% të vlerës totale të projektit.



4.5 Shqipëria

Në Shqipëri mund të gjenden këto forma të mbështetjes financiare:

- **Fondi i Komunitetit** nga Bashkia e Tiranës, e cila mbështet 50% të fondit të nevojshëm për familjarët që duan të investojnë në termoizolimim e e blloqeve të ndërtesave.
- **Fondi për Efiçencën e Energjisë**, për momentin janë vetëm parashikime, dhe jo operacionale.

4.6 Sllovenia

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur incentivat për eficiency e energjisë, rinovimi i shtëpisë dhe incentiva për burimet e rinovueshme sipas rregulloreve Sllovene.

Pajisjet	Incentivat
Izolimi	Izolimi i fasadës: ndërtesa të vjetra individuale – deri në 20% ose max 12 Euro / m2; ndërtesa shumëkatëshe – deri në 20% ose max 16 Euro / m2; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; për më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/izolacija-fasade ; izolimi i bodrumit dhe dyshensë: ndërtesa të vjetra individuale - deri në 20% ose maksimumi 12 Euro / m2; ndërtesa shumëkatëshe – deri në 20% ose maksimumi 12 Euro / m2; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/izolacija-kleti-in-tal ; izolimi i çatisë ose tavanit: ndërtesa individuale të vjetra – deri në 20% ose maksimumi 12 Euro / m2; ndërtesa shumëkatëshe – deri në 20% ose maksimumi 16 Euro / m2; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/izolacija-strehe-ali-stropa-proti-neogrevanemu-prostoru
Dritare dhe pajisje	Ndryshimi i dritareve të vjetra me të reja druri: ndërtesa individuale të vjetra - 20% ose maksimumi 150 Euro /m2 për ndryshim dritareshe; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/zunanje-stavbno-pohistvo
Panele diellore	Sisteme dillore të ngrohjes: 30% ose maksimumi 300 Euro/m2, gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/solarni-ogrevalni-sistem ; termocentrale mikro fotovoltaike: deri në 180 Euro për 1 kva për ndërtesat individuale dhe ato shumëkatëshe; për më shumë informacion lexoni: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/mikro-soncne-elektrarne
Sistemi i ajrosjes me rikthim të nxehtësisë	Sistemi lokal ose qendror për ajrim me rikthim të nxehtësisë: për individët – deri në 20% ose 2000 Euro; për ndërtesat shumëkatëshe: 30%; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/sistemi-za-prezracevanje-z-vracanjem-toplote-rekuperacija

Lidhja me sistemin qendror të ngrohjes	Lidhje individuale: deri në 50% ose 3000 EURO; ndërtesat shumëkatëshe: 25%; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/priklop-na-omreje-daljinskega-ogrevanja-3
Rinovim rrenjësor i ndërtesës	Ndërtesat individuale: 170 EURO/m ² për ngrohjen e hapësirës ose 200 EURO/m ² të hapësirës së ngrohur (në varësi të llojit të izolimit të përdorur) për më shumë informacion lexoni në: https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/celovita-obnova-stanovanjske-stavbe/celovita-obnova-stanovanjske-stavbe-subvencija
Subvencion për blerjen e një banese në një ndërtesë të re ose ndërtesë me energji zero	Blerja e një apartamenti në një ndërtesë shumëkatëshe: deri në 80 m ² me subvencion prej 100 Euro për m ² të sipërfaqes neto të ngrohur të banesës të spondërtuar në një ndërtesë shumëkatëshe shumë-banesore dhe shtrirjen e re në ndërtesën e vjetër shumëkatëshe të rinovuar plotësisht; ose 150 Euro për m ² të zonës neto të ngrohur të apartamentit të rinovuar tërësisht në një ndërtesë të vjetër shumëkatëshe.
Subvencion për ndërtesat me energji të ulët ose energji afërisht zero	Nga 65-135 Euro/m ² të sipërfaqes neto të ngrohur dhe ajrosur; gjithashtu kredi të favorshme janë në dispozicion; më shumë informacion lexoni në https://ekosklad.si/prebivalstvo/pridobite-spodbudo/seznam-spodbud/skoraj-nic-energijske-in-nizkoenergijske-stavbe/skoraj-nic-energijske-in-nizkoenergijske-stavbe-subvencija





5 Shtojca

Shtojca 1 - Tabela e incentivave

Tabelë 1- Përmbledhja e incentivave dhe mbështetja financiare në zonat e marra në studim

Pajisjet e reja	Karakteristikat					
	Itali	Spanjë	Francë	Kroaci	Shqipëri	Slloveni
<p>Frigorifer</p> <p>Furrë</p> <p>Makinë larëse</p> <p>Lavastovilje</p>	<p>Bonuse për pajisjet elektroshtëpiake: lehtësim taksash për ata të cilët kryejnë punime rinovuese në ndërtesa.</p> <p>Pajisje me efikasitet energjie, klasa A+, e barabartë ose më e lartë.</p>	<p>Plan rinovimi për elektroshtëpiaket.</p>	<p>Nuk ka incentiva në nivel kombëtar dhe atë rajonal. Ndoshta në ndonjë nivel lokal.</p>	<p>Për momentin nuk ka fonde shtëse nga Fondi për Mrojtjen e Mjedisit dhe Efienca e Energjisë.</p>	<p>Kredi të zbutura bankare për pajisjet EE.</p>	<p>Kredi të favorshme për pajisjet shtëpiake A+ ose të klasës më të lartë</p>
<p>Bojler</p> <p>Sistemi ngrohës</p>	<p>Ecobonus për ndërhyrjet të cilat rrisin efikasitetin e energjisë në ndërtesat ekzistuese.</p>	<p>Çdo rajon aktivizon fushën e vet specifike për efikasitetin e energjisë. Katalunja nuk mbështet këto lloj shërbimesh për bojlerët dhe sistemet e ngrohjes.</p>	<p>MaPrimeRenov: deri në 1 200 Euro për ndryshimin e bojlerit</p> <p>MaPrimeRenov: deri në 4 000 Euro për sistemin ngrohës (sistemin ajër-ujë) dhe 10 000 Euro për sistemin e ngrohjes gjeotermal.</p>	<p>Hapur thirrja për qytetarët të cilët instalojnë një burim për energjinë e rinovueshme për prodhimin e energjisë termale për ngrohje apo ftohje. Buxheti total i programit = 11 mil kuna; Qytetarët mund të marrin maksimalisht 75 mijë kuna.</p>	<p>Huatë e Gjelbërta nga Bankat.</p>	<p>Investime individuale: deri në 50%; investime në ndërtesa shumëkatëshe: 25 % e investimit</p> <p>Investime individuale: nga 20-60%; ndërtesa shumëkatëshe 25 %</p>

Izolimi	Ecobonus: ata të cilët kryejnë rizhvillimin e energjisë në ndërtesa mund të përfitojnë nga reduktimi i taksës deri në 75%.	Qeveria Katalanase (Generalitat) ofron mbështetje të përvitshme përmes IDAE.	MaPrimeRenov për efiçencën e energjisë: deri në up to 100 Euro / m ² për izolimin e murit	Thirrje të ndryshme për rinovimin e ndërtesave rezidente dhe shtëpitë e familjeve. Qyetarët mund të marrin për rinovimin e ndërtesave të tyre një vlerë nga 29 deri 95% vlerës totale të projektit.	Fonde për Komunitetin nga Bashkia Tiranë.	Ndërtesa të vjetra individuale – deri në 20% ose maksimumi 12 Euro / m ² ; ndërtesa shumëkatëshe – deri në 20% ose maksimumi 16 Euro / m ²
Dritaret dhe pajisjet			MaPrimeRenov për efiçencën e energjisë: deri në 100 Euro / për zëvendësimin e dritares me një xham të vetëm.			Ndërtesa individual të vjetra - 20% ose maksimumi 150 Euro /m ² për dritare të ndërruar
Panelet diellore	Llogaria termike 2.0: mbështetje për rritjen e EE dhe prodhimin e energjisë termike nga BER.	IDAE dhe ICAEN mundësojnë mbështetje të përvitshme	MaPrimeRenov për efiçencën e energjisë: deri në 4 000 Euro për ngrohës diellor për ujin.	Disa fondë për bojler dhe pompa ngrohëse	Parashikime në Fondin për Efiçencën e Energjisë, por ende nuk funksionon.	30% ose maksimumi 300 Euro/m ²



Shtojca 2 - Tabelë energjie